



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GRAMSH

Data \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** Rikonstruksion i rrugës së brendshme në fshatin Trashovicë,  
Njësia Administrative Pishaj

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT**  
(CPV): Punime rrugore 45233140-2

**VLERA E FONDIT LIMIT:** me fond limit 49 349 932 (dyzet e nëntë milion e treqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy) lekë pa tvsh dhe 59 219 918.94 (pesëdhjetë e nëntë milion e dyqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë e katër) lekë pa tvsh. Ky objekt prokurimi do të financohet gjatë 3 viteve .Konkretisht për vitin 2026 do të financohet vlera 11 848 000 ( njëmbëdhjetë milion e tetëqind e dyzet e tetë mijë) lekë me tvsh, në vitin 2027 vlera 25 500 000 ( tridhjetë e pesë milion e pesëqind mijë ) lekë me tvsh dhe për vitin 2028 vlera 21 871 918.9 (njëmbëdhjetë milion e tetëqind e shtatedhjetë e një mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë pikë nëntë) lekë me tvsh.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Gramsh** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023,2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e perlllogaritur e kontrates qe do te prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, 2025**, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht:

**Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998** “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton” Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në

të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

**Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 5** datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar pika 3.12 e tij, dhe kërkesave të **Ligjit Nr. 25 date 10.05.2018** "Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 9 i tij ku parashikohet: "Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përjashtimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministripërgjegjës për financat".

**Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009** "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar" (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike" gjykojme që të kërkojme xhiron vjetore dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2022, 2023, 2024) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Ndërsa në **nenin 88** "Bashkimi i operatorëve ekonomikë" të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

*"3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**"*

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2025** dhe kestet e maturuara për vitin **2026**, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar), lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

**Argumentimi:** Njësia e prokurimit kërkoi edhe pagesat e taksave vendore bazuar në Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (të ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore si dhe faktit ku në zbatim të legjislationit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se ulët se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

a) Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- a. Kontratën e Sipërmarrjes,
- b. Situacionin përfundimtar të objektit
- c. Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore
- d. Aktin e Kolaudimit të objektit
- e. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit
- f. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtme:

- a. Kontratën e Sipërmarrjes,
- b. Situacionin përfundimtar të objektit
- c. Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore
- d. Aktin e Kolaudimit të objektit
- e. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9

*Shenim: Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e*

*bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

**4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë** burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”*

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi” të ndryshuar, e cila perfshin kategorite e meposhtme:

- N.P –1– A Punime germimi ne tokë;
- NP–4– A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
- NS – 6 – A Sinjalistika rrugore jondriçuese

- NS-18- A Punime topogjodezike.

*Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

*Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.*

*Kategorite dhe nivelet e licencave të kërkuara janë bazuar në Lidhjen 2,3 dhe 4 të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.*

### **Konkretisht:**

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

<b>KAT.</b>	<b>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</b>	<b>Nr. An</b>	<b>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</b>	<b>Niveli I klasifikimit I kerkuar per kategoriarespektive</b>
<b>NP-1</b>	Punime gërmimi në tokë			<b>Niveli A</b>
<b>NP-4</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha,</li> </ul>			<b>Niveli A</b>

	tramvaj, metro, pista aeroportuale			
NS-6	Sinjalistika rrugore jondriçuese			Niveli A
NS-18	Punime topogjodezike.			Niveli A

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
Inxhinier Transporti	1 (një)
Inxhinier Hidroteknik	1 (një)
Inxhinier Elektrik	1 (një)
Inxhinier Gjeodet/Topograf	1 (një)

**Argumentimi:** Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për Inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Stafi i Inxhinierëve, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

**Inxhinieri i Ndërtimit** kërkohe për zbatimin e saktë të punimeve të ndërtimit që do të zhvillohen në objekt

**Inxhinier Topograf/Gjeodet** është i nevojshëm për zbatimin e saktë të punimeve gjeodezike duke përfshirë punime si piketimi, rievime të ndryshme topografike në sisteme koordinative të ndryshme caktimi i kuotave të kërkuara nga projekti, azhornime të ndryshme, përvoja e përket sistemit të terreneve të jashtme.

**Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventiv, sipas parashikimeve në projektet Elektrike përkatëse. Zërat e përfshirë në preventiv shoqërohen me zgjidhet teknike të hartuara nga eksperti inxhinier elektrik në projekt, në relacionin teknik dhe specifikimet teknike. Për këtë arsye, lind nevoja që për zbatimin e punimeve në të gjitha vëllimet e objektit të angazhohet një inxhinier elektrik të përfshirë në licensën e shoqërisë.

**Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidraulike, lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventivin, sipas parashikimeve në projekt.

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licensën e shoqërisë), si më poshtë:

a. (Një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumine datën e hapjes së tenderit. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").*

**Argumentimi:** Në mbështetje të nenit 7 të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" ku citohet..... *"Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion".*

Specialisti për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë harton planin e sigurisë dhe të koordinimit në kantier, parapërgatit një dosje, e cila përmban informacionet e nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen nga rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar punëtorët, hartojnë planin operativ të sigurisë, kryejnë mirëmbajtjen e kontrollin para fillimit të punës dhe kontrollin periodic të impianteve dhe pajisjeve të punës me qëllim eliminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë ose shëndetin e punëmarrësve.

Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e

përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës. Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë", janë të nevojshëm për të menaxhuar emergjencat gjatë punimeve dhe të sigurojnë mbrojtjen e shendetit në punë.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- Betonues 4 (katër)
- Hekurthyes 2 (dy)
- Elektracistë 2 (dy)
- Hidraulik 2 (dy)
- Karpentier 2 (dy)
- Punonjes te thjeshte ndertimi 12 (dymbëdhjetë)
- Saldatorë 2(dy)
- Automakinist 2 (dy)
- Eskavatorist 2 (dy)
- Shofer me CAP 4 (katër)

**Teknik me shkolle te mesme**

- Teknik Ndërtimi 1 (nje)
- Teknik Topograf/Gjeodet/Gjeometër 1 ((një)
- Teknik Elektrik 1 (një)

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)	Nr Amzes
1					
2					

etj					
-----	--	--	--	--	--

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/ diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore.
- Per tekniket te paraqitet diploma e shkolles se mesme/diplome bachelor

Për punonjësit manovratorët-shoferet, ofertuesi duhet të paraqesë:

a) kontratë individuale të punës;

b) leje drejtimi, certifikate e aftesimit profesional (CAP) për shoferet dhe dëshmi aftesimi profesional (DAP) për manovratorët-shoferet, që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimë dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Në rastin kur punonjësit manovratorët-shoferet janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

Punonjësit e mesiperm duhet figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për gjashtë muajt e fundit

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga

autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional.

**Teknik Ndërtimi 1 (një )** janë të nevojshëm për ndjekjen e realizimin e punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve. Kërkesa e AK për 2 (dy) Teknike Ndërtimi vjen pasi objekti i prokurimit do të jetë i shtrirë në me shume se dy fronte njëkohësisht (rikonstruksioni total i godines ne te treja katet e saj, ndertimi i shteses (tualetet e reja ne cdo kat), ndertimi i palestres dhe sistemimet e jashtme). Për këtë arsye gjykohet e arsyeshme prania e dy punonjësve të tillë në mënyrë që të arrijnë të kontrollohen punimet specifike në cdo faze.

**Tekniku Elektrik 1 (një )** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve dhe instalimeve elektrike, për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses.

**Tekniku Topograf 1 (një )** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të ndërtimit nga e para si dhe punimet e sistemimit të jashtëm. Të gjitha keto punime kërkojnë precizion në kuota dhe nivele të caktuara për piketimin dhe monitorimin e strukturave dhe elementeve të ndryshëm.

**Elektracist 2(dy)** janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve dhe instalimeve elektrike, sipas zërave të preventivave të punimeve.

**Hidraulike 2(dy)** persona janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve dhe instalimeve hidraulike, sipas zërave të preventivave të punimeve.

**Karpentier 2(dy)** janë të nevojshëm pasi në zërat e preventivit përfshihen punime betoni, kallëpet, shtresat dhe hekuri periodik ndërtimi, montimi i skelave për punimet në lartësi, etj.

**Betonues 4 (katër)** janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të betonimit, me klasen e duhur sipas zërave të preventivave të punimeve.

**Hekurkthyes 2(dy)** janë të nevojshëm pasi në zërat e preventivit përfshihen përpunimi dhe lidhja e hekurit të ndërtimit duke përdorur mjetet e duhura, sipas zërave të preventivit të punimeve.

### **2.3.6 Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e 6 muajve të fundit , ku te kete te punesuar minimumi 42(dyzet dy) persona.**

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për **6 muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për **6 muajt** e fundit të deklaruar.

*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.* Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 42 punonjës duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Bazuar në këto elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore).

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

2.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Gjendja
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 - 12 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
2	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës deri 25 T ton	2 cope	Në pronësi ose me qera
3	Autovinc deri 5-6 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera

4	Fadrome me goma (mjet teknologjik)	1 copë	Në pronësi ose me qera
5	Makineri vijëzimi	1 copë	Në pronësi ose me qera
6	Minifadrome (mjet teknologjik)	1 copë	Në pronësi ose me qera
7	Minidumper (mjet teknologjik)	1 copë	Në pronësi ose me qera
8	Vibratorë betoni	2 copë	Në pronësi ose me qera
9	Rrul Vibrues Hekur-Hekur	1 copë	Në pronësi ose me qera
10	Rrul Vibrues Gome-Hekur	1 copë	Në pronësi ose me qera
11	Asfaltoshtruese	1 copë	Në pronësi ose me qera
12	Autobitumatrice	1 copë	Në pronësi ose me qera
13	Grejder (mjet teknologjik)	2 copë	Në pronësi ose me qera
14	Eskavator me zinxhir	1 copë	Në pronësi ose me qera
15	Cekic Pneumatik	1 copë	Në pronësi ose me qera
16	Motogjeneratorë	2 copë	Në pronësi ose me qera
17	Tabela sigurimi në punë	10 copë	Në pronësi ose me qera
18	Matrapik	2 copë	Në pronësi ose me qera
19	Kontenierë për puntorë	1 copë	Në pronësi ose me qera
20	Eskavator me goma (mjet teknologjik)	1 copë	Në pronësi ose me qera
21	Fabrikë Betoni (e pajisur me leje mjedisore kodit III.1.B)	1 copë	Në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi
22	Fabrikë asfalti (e pajisur me leje mjedisore kodit III.1.B)	1 copë	Në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi
23	Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore kodit III.1.B)	1 copë	Në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi
24	Autobetoniere	1 copë	Në pronësi ose me qera
25	Jelekë, kokore	42 copë	Në pronësi ose me qera

**Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm :**

Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet :

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.
- f) çertifikatë transporti

Kur janë me qera, duhet të paraqitet :

- a) kontrata noteriale e qerasë;
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);

- c) *çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);*
- d) *siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;*
- e) *foto ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.*
- f) *çertifikatë transporti*

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimit të mjetit dhe foto të tyre.

Për impiantin e asfaltit, të betonit dhe nyjen e inerteve duhet të paraqiten kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot ose fatura tatimore përkatëse, lejen mjedisore lëshuar nga QKL. Nëse është marrë me qira/furnizim, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimit. Operatori ekonomik për fabrikën e asfaltit, të betonit dhe nyjen e inerteve mund të paraqesë edhe kontrata të vlefshme furnizimi me operatorë ekonomikë. Në këtë rast, duhet të paraqesë kontratën e furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton ekzistencën dhe pronësinë e impiantit, si dhe lejen mjedisore kodi III.1.B lëshuar nga QKL.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi/qera ose kontrate bashkepunimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, specifikeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Sasia e mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

**Analizë në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që kërkohen nga autoriteti kontraktor:**

- **Kamion vetëshkarkues 10–12 ton (1 copë)** – Siguron transport të materialeve të vogla ose të mesme brenda kantierit, duke mbajtur ritëm pune të pandërprerë.
- **Kamionë vetëshkarkues deri 25 ton (2 copë)** – Nevojiten për transportin e volumit të madh të materialeve, për të shmangur vonesat dhe ndërprerjet në punimet strukturore.
- **Autovinc deri 5–6 ton (1 copë)** – Mundëson ngritje dhe vendosje të elementeve strukturore në lartësi, duke garantuar siguri dhe efikasitet. Në preventiv janë parashikuar punime për muret pritëse Gabioni, kryesisht:

- gabiona me rrjet teli të zinguar, gurë kove 1x1x1 m, në sasinë prej 436 m<sup>3</sup>;
- gabiona me rrjet teli të zinguar, gurë kove 1x1x1.5 m, në sasinë prej 436 m<sup>3</sup>;

Gjithashtu janë parashikuar punime për Tombinë:

- Tombinë me tuba Ø 600, mbi shtresë betoni 32 metër/ total
- Tombinë me tuba betoni Ø 1000 metër mbi shtresën beton 6 metër /total.

Për të kryer këto punime është munduar të përdoret 1 Autovinça 5-6 ton

Argumentimi:

Gabionet janë të plotë me gurë kove me dendësi tipike 2,600 kg/m<sup>3</sup>, (2,6 ton/m<sup>3</sup>).

Pesha e rrjetës, kuadrit metalik (teli zinxhiruar), e llogarisim si 50 kg/m<sup>3</sup>, (0,05 ton/m<sup>3</sup>) për të përfshirë koston e koshit.

### 1) Numri i gabionëve

- Gabiona 1 x 1 x 1 m → volumi i njërit = 1.0 m<sup>3</sup>  
Sasia totale e preventivuar (kerkuar) = 436 m<sup>3</sup>  
Numri = 436 / 1 = 436 gabionë
- Gabiona 1 x 1 x 1.5 m → volumi i njësit = 1.5 m<sup>3</sup>  
Sasia totale e preventivuar (kërkuar) = 654 m<sup>3</sup>  
Numri = 654 / 1.5 = 436 gabionë

### 2) Pesha për gabion (copë- copë)

- Për 1 m<sup>3</sup>: gur = 2.6 t + rrjetë ≈ 0.05 t => 2.65 t për gabion  
1 x 1 x 1 m
- Për 1.5 m<sup>3</sup>: gur = 1.5 x 2.6 = 3.90 t + rrjeta = 0.075 t => 3.975 t për gabion  
1 x 1 x 1.5 m

Shënim: pesha e rrjetës/ kuadrit metalik(teli i zinguar) e llogarisim si 75 kg/m<sup>3</sup> (0.075 t/m<sup>3</sup>) për të përfshirë koston e koshit, për gabiona = 75 kg/m<sup>3</sup> (0.075 t/m<sup>3</sup>) 1 x 1 x 1.5 m

3) Pesha totale

$$436 \text{ gabion} \times 2.65 \text{ t} = 1,155.40 \text{ t}$$

$$436 \text{ gabion} \times 3.975 \text{ t} = 1,733.10 \text{ t}$$

**Pesha totale e të gjithë materialit  $\approx$  2,888.5 ton (afërsisht 2,889 t)**

– Tombinot  $\varnothing$ 600 dhe  $\varnothing$ 1000

**$\varnothing$  e interpretojmë si diametër të brendshëm (600 mm dhe 1000 mm)**

**Trashësia e murit = 75 mm për  $\varnothing$ 600 dhe 100 për  $\varnothing$ 1000**

**Dendësia e betonit = 2,400 kg/m<sup>3</sup> (këtë llogaritje kemi marrë)**

1) Pesha për Tombino 1 m  $\varnothing$ 600, llogaritet: **381.70 kg**

**$\approx$  0.382 t për tub 1 m**

2) Pesha për Tombino 1 m  $\varnothing$ 1000, llogaritet: **829.38 kg**

**$\approx$  0.829 t për tub 1 m**

3) Sasia totale:

$$\varnothing 600: 32 \text{ copë} \times 0.3817 \text{ t} \approx 12.214 \text{ t}$$

$$\varnothing 1000: 6 \text{ copë} \times 0.8294 \text{ t} \approx 4.976 \text{ t}$$

**Pesha totale e të gjithë tubave = 17.19 ton**

- **Fadrome me goma (1 copë)** – Përdoret për ngarkim, shkarkim dhe lëvizje të materialeve voluminoze në terren të ndryshëm, duke rritur produktivitetin.
- **Makineri vijëzimi (1 copë)** – Siguron shënjimimin e saktë të sipërfaqeve asfaltike dhe rrugore sipas standardeve të sigurisë.
- **Minifadrome (1 copë)** – Transport i brendshëm i materialeve në kantier, sidomos në zona ku kamionët e mëdhenj nuk mund të operojnë.
- **Minidumper (1 copë)** – Lëvizje dhe shpërndarje e materialeve të vogla në mënyrë të shpejtë dhe efikase brenda kantierit.

- **Vibratorë betoni (2 copë)** – Sigurojnë kompaktimin e betonit, duke parandaluar boshllëqet dhe duke garantuar qëndrueshmëri strukturore.
- **Rrul vibrues Hekur-Hekur (1 copë)** – Përdoret për armatimin e betonit, duke siguruar lidhje të forta dhe qëndrueshmëri të strukturave.
- **Rrul vibrues Gome-Hekur (1 copë)** – Mundëson lidhje të betonit me elemente të ndryshme, duke garantuar cilësi sipas projektit. Në këtë investim apo kantier do të përdorim 2 rrula,

1 RRUL hekur-hekur

1 RRUL gome-gome

Argumentimi:

- 1) E gjithë gjatësia e rrugës në dy lotet e paraqitura në preventiv është 1450 ml me një gjerësi m<sup>3</sup> (karrexhata).

Parametër:	Vlerë:
gjatësia e rrugës	1.450 ml
gjërësia asphalt	3 m ( vetëm karrexhata)
sip.për binder/asphalt	4.664 për secilën shtresë
trashësia	4 cm=0.04 m
volume për secilën shtresë	$4.664 * 0.04 = 186.56 \sim 187 \text{m}^3$

- 2) Numri I kalimeve për të mbuluar gjerësinë

Gjerësia e rrulit; 2m

Gjerësia e rrugës; 3m

Pra secili rrul duhet të bëjë 2 kalime për të mbuluar të gjithë gjerësinë.

- 3) Numri I rrulave

Do përdoret një rrul hekur – hekur për binderin

Do përdoret një rrul gome- gomë për asfaltin

Secili rrugbën 2 kalime në gjatësinë 1.450 ml pëe të dyja lotet.

Në praktikë kjo do të thotë:

Shtresa	Rrul	Nr.rrulave	Kalim për rrul
Binder	Hekur-hekur	1	2
Asfalt	Gome - gomë	1	2

#### 4) Argumenti praktik

##### Rruli hekur-heku(binder)

Kjo pajisje është një kompaktor me rrota metalike të forta dhe ka funksion kryesor të densifikojë dhe të shtrëngoje materialet e rrugës.

Rruli metalik shtyp fort materialin e shtresës buzë, binder, bazë, tokë e stabilizuar. Pesha e këtij rruli metalik siguron që grimcat e materialit lidhen fort, ku mos të ketë boshllëqe ajri. Rruga pas ngjeshjes apo shtypje ka stabilitet dhe jetëgjatësi më të madhe.

Ky rrul nuk mund të përdoret për të lëmuar sipërfaqe të dukshme sepse rruli metalik mund të lëri shenja mbi shtresën finale, asfaltin. Ai përdoret për binder ose shtresat baze të rrugës.

##### Rruli gomë-gomë

Rruli gomë gomë shërben dhe do të përdoret në kantierin tonë për të lëmuar sipërfaqen, pra shtresën e asfaltimit. Një rrul gomë –gomë është mëse I mjaftuesëm për 3 cm gjerësi rruge dke kaluar 2 herë.

Përse duhet kjo makineri?

Me anë të kësaj makinerie rruga fiton fortësi dhe qëndrueshmëri,pra sip.mbetet e lëmuar. Përfundimisht ky rrul është kompaktor për asfaltin final, garanton sipërfaqe të sheshtë dhe të dukshme pa shenja të rrotave metalike.

5) Pse është kërkuar që në object të jenë 2 rrula, duke llogaritur kohënqë u duhet për të përfunduar punën në raport me grafikun e punës?

- Sipërfaqja për një kalim

Sip. E një kalim= gjatësi \* gjerësi e rrullit.

$$1.450*2=2.900\text{m}^2$$

Numri I kalimeve=2

$$2*2.900=5.800\text{m}^2$$

Duhet theksuar se sipërfaqja reale e shtresës binder/asphalt është  $4.664 \text{ m}^2 \rightarrow$  do të mjaftojnë pak më shumë se 2 kalime të plota, por për rrumbullakim, siguri dhe uniformitet do të konsiderojmë 2 kalime.

- Shpejtësia e punës:
- Një rrul tipik mundë të mbulojë 8-12 m/min gjatësi ngjeshjes.
- Ne do të marrim një mesatare 10 m/min , gjatësia e rrugës 1.450m:
- Numri I kalimeve -2
- $2*2.4=4.8$  orë ~ 5 orë

Shënim: çfarë është 2.4

Argumentim

$$\text{Koha për një kalim} = \frac{\text{Gjerësia e rrugës}}{\text{shpejtësi e rrullit}}$$

- Gjatësi e rrugës = 1.450 m
- Shpejtësia e rrullit =10 m/min (mesatare)

$$\text{Koha (min)} = 1.450/10 = 145 \text{ min}$$

- 145 minuta e konvertojmë në orë:
- $145/60 \sim 2.42$  orë ~ 1.4 orë

Pra 2.4 orë = koha që I duhet rrullit për të bërë një laim të plptë të rrugës 1.450 m gjatësi.

- Pasi duhen 2 kalime për të mbuluar gjithë gjerësinë e rrugës:  
 $2*2.4=4.8$ orë ~ 5 orë për të mbuluar gjithë shtresën.  
2.4 orë është koha për një kalim të vetëm të rrullit.

Pra një rrul mund të përfundojë binderin në rrethë 5 orë.

E njëjta logjikë përdoret dhe për asfaltin ~ 5 orë.

6) Koha totale për të dyja shtresat.

- Me një rrul hekur-hekur për binder dhe një rrul gomë-gomë për asfalt, gjithë rruga 1.450m\*3m mund të mbarojë rreth një ditë punë intensive. Përfundimisht 2 rrula janë mëse të mjaftueshëm për këtë projekt mbi baze preventive.
- **Asfaltoshtruese (1 copë)** – Vendos shtresën asfaltike në mënyrë uniforme dhe të qëndrueshme sipas standardeve. Makinë asfaltuese është e nevojshme dhe e duhur për kantierib tonë pasi ajo do të realizojë shpërndarjen e materialit në mënyrë uniforme. Në këtë project zbatimapo në këtë kantier është mëse e mjaftueshme vetëm 1 asfaktuese.

Argumentimi:

1) Shpërndan materialin uniform

- Merr asfaltin apo materialin binder nga kamionet dhe e shpërndan mbi sipërfaqen e rrugës.
- Siguron që trashësia e shtresës të jëtë e njëtrajtshme sipas projektit dhe preventivit (4cm)
- Pa këtë makineri, shpërndarja manualedo të ishte shumë e ngadaltë dhe e pasaktë, duke rrezikuar trashësi të ndryshme dhe deformime të rrgës .

2) Nivelon dhe formon shtresën

- Makineria ka system nivelimi që siguron sipërfaqe të sheshtë dhe uniform.
- Ky system që disponon makineria në fjalë mund të rregullohet për trashësi të ndryshme dhe për të dhënë pjerrtësi të vogël për kalimin e ujit.

3) Kur kombinohet me kompaktor (RRUL)

- Asfalto shtruesja e hedh materialin e lë shtresën gati për kompaktim
- Asfaltobetoni apo binderi nuk mund të sheshohet apo shtrëngohet mirë nëse nuk është shpërndarë në mënyrë uniforme.

4) Rrit efikasitetin dhe sigurinë.

- Kjo makineri mund dhe do të mbulojë qindar m<sup>2</sup> në një ditë, shumë më shpejt se shpërndarja manual.
- Gjithashtu do të reduktojë lodhjen fizike te punëtorëve dhe zvogëlon gabimet njerëzore.

Argumentim praktik:

Shtresa jonë për dy lotët e rrugës, binder=4 cm,  $4.664\text{m}^2 \rightarrow \text{volum} \sim 187\text{m}^3$ . Nëse do e shpërndanim manualisht, çdo ditë kjo punëdo te merte disa ose me shumë ditë.

Kjo makineri e bën shpejt ,saktë dhe me uniformitet duke lejuar që rruli të bëjë kompaktin efektiv.

Duhet theksuar se e njëjta gjë vlen edhe për asfaltobetonin.

Përfundimisht pa asfaltuesin do të kemi në finale një shtresë të pa barabartë, deformime, ujë të grumbulluar dhe jetë të shkurtëe të rrugës.

- **Autobitumatrice (1 copë)** – Siguron transportin dhe përhapjen e bitumit në sipërfaqe të mëdha për asfaltim cilësor. Sipas preventivit loti 1 + loti 2, sipërfaqja më .... bituminoz  $1\text{ l/m}^2$  që do të hidhet lloogarithet rreth 4.703 litra.

Për të shpërndarë 4.703 litra emulsion bituminoz mbi sipërfaqen e rrugës ( $4.664\text{m}^2$  sip.binder), autobitumatrice siguron shpërndarjen uniforme me sasi të kontrolluar për  $\text{m}^2$ .

Pra do të hidhet 1 litër emulsion/ $\text{m}^2$ , kjo është normale për .... Bituminozë bazë para asfaltit.

$$4.703 \text{ litra} / 4.664 \text{ m}^2 \sim 1 \text{ l/m}^2$$

Përfundimisht autobitumatrice është domozdoshmëri për këtë projekt-zbatimi. Pa të shpërndarja manual nuk do të jete uniform dhe do të ndikojë në cilësinë e asfaltit

- **Grejder (2 copë)** – Përdoret për nivelim dhe rregullim të terrenit, duke përgatitur bazën për punime të mëtejshme. Kjo makineri duhet shtuar si kriter pasi ai është shumë I rëndësishëm për profesionalizimin dhe nivelimin me sakësi të lartë të tokës ose shtresave të rrugës.

Në këtë objekt Grejderi do të realizojë sipërfaqen e rrugës plotësisht të rrafshët dhe me pjerrësitë (bankinat 0.5 m nga njëra anë) të sakta. Gjithashtu duhet theksuar se kjo makineri (grejder) jep formën finale të shtresave të rrugës:

- Shtresa balaste
- Stabilizant
- Nënbazë
- Bazë

Pas punës së ekskavatorit dhe buldozierit, grejderi do të realizojë nivelimin përfundimtar në +/- 1 cm saktësi. Pa këtë pajisje në këto punime që do të kryhen, cilësia e shtresës së rrugës nuk del perfekte. Infrastruktura e përshkruar në preventiv dhe projekt do ketë edhe shtresën e stabilizantit e cila llogaritet 15 cm, dhe për të qenë e rrafshët duhet medoemos Grejderi.

Për objektin në fjalë i cili karakterizohet në 2 lote, i pari 1200 ml dhe i dyti 250 ml, pra në total 1450 ml; dhe një shtresë stabilizanti 15 cm për volum total 831 m<sup>3</sup> është i nevojshëm vetëm 1 Grejder.

- **Eskavator me zinxhir (1 copë)** – Gërmime dhe lëvizje të materialeve të mëdha, sidomos në terrene të vështira. Për të gërmuar 4.192 m<sup>3</sup> tokë e zakonshme (natyrale + formim dhe shkallëzim skarputash + karikim materialesh në kamionë zim skarputash + karikim materialesh në kamionë është i nevojshëm vetëm 1 ekskavator me zinxhir (gërmues hidraulik). Është zgjedhur kjo makineri, pasi:

- 1) Ka force më të madhe gërmimi, sidomos në terren natyral, të forte ose të pabarabartë.
- 2) Është shumë stabilpër skarpatim, prerje, profilizime.
- 3) Ky mjet I kërkuar mund të punojë në zona të buta pa vështirësi ose pa u mbyllur.
- 4) Jep produktivitet më të lartë në volum të madh gërmimi.

Ekskavatori I kërkuar në këtë punë apo procedure duhet të ketë këto karakteristika:

- Kapaciteti 20-30 ton
- Kovë 0.8 - 1.2 m<sup>3</sup>
- me zinxhir (tracked)

Ky ekskavator me kovë 0.8 – 1.2 m<sup>3</sup>, konsiderohet i madh dhe mund të gërmojë 250 – 400 m<sup>3</sup>/ditë, kjo edhe në varësi të distances së ngarkimit.

Pra, 4.192 m<sup>3</sup> gërmim mund të realizohen për 10-14 ditë punë efektive.

Duke qenë se ka dhe sjkallëzim skarpace, ky vëllim është shumë normal për 1 njësi (mjet të tillë).

- **Çekiç pneumatik (1 copë)** – Shkatërrim dhe modifikim i betonit ose sipërfaqeve të forta kur kërkohet.
- **Motogjeneratorë (2 copë)** – Sigurojnë energji për operimin e pajisjeve dhe makinerive në kantier, duke garantuar vazhdimësinë e punës.
- **Tabela sigurimi në punë (10 copë)** – Sigurojnë informacion dhe paralajmërim për sigurinë e punonjësve dhe vizitorëve.
- **Matrapik (2 copë)** – Përdoret për shënjimimin e vijave në rrugë dhe trotuare sipas standardeve të trafikut.

- **Kontenier për puntorë (1 copë)** – Shërben si magazinë dhe qendër organizative, duke mbajtur kantierin të organizuar dhe të sigurt.
  - **Eskavator me goma (1 copë)** – Lëvizje dhe ngarkim materialesh në terrene të lëmuara ose ku kërkohet fleksibilitet më i madh.
  - **Fabrikë betoni (1 copë)** – Siguron furnizim të vazhdueshëm me beton të cilësisë së standardizuar, me leje mjedisore.
  - **Fabrikë asfalti (1 copë)** – Furnizon asfalt të përgatitur sipas standardeve, duke garantuar cilësi dhe ritëm pune.
  - **Nyje inerte (1 copë)** – Siguron material bazë për ndërtim, me kontroll të cilësisë dhe leje mjedisore.
- **Autobetoniere (1 copë)** – Transport i betonit të përzier drejt vendndodhjes së punimeve, për të ruajtur cilësinë dhe kohën e vendosjes. Në Rikonstruksionin e rrugës të brendshme të fshatit Trashovicë, N.J.A. Pishaj, Bashkia Gramsh, është parashikuar edhe hedhje betoni për disa zëra punimesh që do të kryhen si:
- Beton për kanalet - kallëpet 270 m<sup>3</sup>
  - Shtresa betoni C16/20 për kunetat anësore 96 m<sup>3</sup>
  - Trotuar, me 6 cm beton, me llustër 500 m<sup>2</sup> e kthyer në m<sup>3</sup> relativisht 30 m<sup>3</sup>.
  - Beton M-200 për fiksimin e tubave në total 5 m<sup>3</sup>

Për të realizuar me efikasitet duhet 1 copë Autobetonierë për këto punë.

Argumentimi:

E gjithë sasia e betonit llogaritet rreth 401 m<sup>3</sup> e cila nuk do të hidhet sigurisht për një ditë, por gjatë fazave të parashikuara në grafikun e punës për 4 muaj dhe preventivit.

1) Parametrat bazë

- Totali beton - 401 m<sup>3</sup>
  - Kohëzgjatja - 4 muaj  $\approx$  120 ditë pune
  - Kapaciteti efektiv autobetonierë = 8 m<sup>3</sup> / ngarkesë
  - Llojet e betonit:
- kanale - 270 m<sup>3</sup>
  - kunetat - 96 m<sup>3</sup>
  - Trotuar 6 cm - 30 m<sup>3</sup>
  - Fiksimi tubash - 5 m<sup>3</sup> (3+2)

2) Llogaritja e sasisë ditore për makinë në mbështetje të grafikut të punës.

- Sasia totale ditore për të përmbushur 4-mujorin:  
401 ÷ 120  $\approx$  3.34 m<sup>3</sup>

- Kapaciteti i një autobetonierë është 8 m<sup>3</sup>
- Me 1 makina kapaciteti teorik maksimal: 8 x 2 = 16 m<sup>3</sup>/ditë

- **Jelekë dhe kokore (42 copë)** – Pajisje mbrojtëse personale për punonjësit, duke respektuar ligjet dhe standardet e sigurisë në punë.

*Shënim: Autoreteti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:*

**2.3.8** Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe menaxhimit të mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme :

- Certifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;
- Certifikatë **ISO 45001:2018** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim;
- Çertifikatë **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.
- Certifikatën **SSH EN ISO 50001:2018**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Energjisë e vlefshme ose ekuivalent).
- Certifikatën **ISO 3834-2:2021**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të cilësisë për proceset e saldimit e vlefshme ose ekuivalent).

Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do të paraqese ISO-t në baze të zerave të punimeve që ka marre përsiper të realizojë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH/EN/UNI mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.14 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

**ISO 9001:2015** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

**ISO 14001:2015** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

**ISO 45001:2018** është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

**ISO 50001:2018** është standard ndërkombëtar, i cili specifikon kërkesat e përgjithshme për krijimin e një Sistemi të Menaxhimit të Energjisë në një organizatë dhe fokusohet në identifikimin e mundësive për përmirësimin e performancës së energjisë. ISO 50001 përcakton synimet dhe objektivat specifike për kursimin e energjisë, të cilat arrihen përmes programeve për menaxhimin e energjisë dhe monitorimin sistematik të variablave të energjisë.

**Standardi ISO 3834-2:2021** përshkruan kërkesat e cilësisë për saldimin me shkrirje të materialeve metalike. Ai zbatohet si në punëtori ashtu edhe në vendet e instalimit në terren dhe është i dizajnuar për aplikime kritike ose me rrezik të lartë të saldimit. Standardi përfshin kërkesa të hollësishme për të siguruar besueshmërinë dhe sigurinë e produkteve të salduara në industri si ndërtimi dhe prodhimi. Për informacion më të detajuar, mund të referoheni dokumentacionit zyrtar të ISO-s këtu.

**2.3.6 Operatori ekonomik në rast se nuk është prodhues duhet të paraqesë kontratë e furnizimit për materialet si me poshtë:**

**2.3.6/1 Tombino:**

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë

autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

### **2.3.7 Per Hekur:**

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

**Argumentimi:** Paraqitja e këtyre dokumenteve është vlerësuar nga njesia e prokurimit pasi duke qënë se në objektin e prokurimit kemi të bëjmë edhe me materiale dhe pajisje që do të vendosen në vepër, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar duhet që këto materiale e pajisje të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: **Autorizim prodhuesi ose distributorin, katalogët ose pjesë të tyre, dëshmitë e testeve të kryera**, me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

Në **nenin 40 pika 6/ b dhe c** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

*“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

**b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose**

**c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”**

Gjithashtu në **nenin 44** “Kërkesat e cilësisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë: **“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.**

**2.3.8** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me license leshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve inerte), se bashke me Akt Miratimin me kodet 17 01 01; 17 01 07; 17 03 02; 17 04 01; 17 04 02; 17 04 05; 17 04 07; 17 04 11; 17 05

04; 17 05 06; 17 05 08; 17 09 04; 20 02 02 në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar

**Argumentim:** Kërkesa për pajisjen e operatorëve ekonomikë me licencë të vlefshme të lëshuar nga QKL për kategorinë **Kodi III.2.B (grumbullim dhe transportim i mbetjeve inerte)**, si dhe disponimi i Akt-Miratimit për kodet përkatëse të mbetjeve, vendoset në përputhje me **ligjin nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 538, datë 26.05.2009, i ndryshuar.**

Ky kriter është i domosdoshëm për të garantuar që operatorët ekonomikë janë të autorizuar ligjërisht për të kryer aktivitetin objekt prokurimi dhe që disponojnë kapacitetin e nevojshëm teknik dhe mjedisor për trajtimin e mbetjeve sipas kodeve përkatëse.

Vendosja e këtij kriteri është në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke synuar realizimin e saj në përputhje me kërkesat ligjore dhe mbrojtjen e mjedisit.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Bazuar në nenin 36 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 39 pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për punimet objekt prokurimi.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.

- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

**Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.**

**NJËSIA E PROKURIMIT**

**ORGENT CONIKU**

**ELONA BOCE**

**LOINA ZOGU**

**ZYRTARI I AUTORIZUAR**

**ZV/KRYETARI**

**XHILSON BAJRAMI**